

Jorgo Bllaci

BIBLIOTEKA

8JH-1  
B 68

EpiKa  
e  
trëndafilave

POEZI

844  
—  
368

Jorgo Billaci

Rezepciot

HERKITT JORGONI

PILLOT ALASDEA T  
MAKSI HAKKUSTAAT

# Epika e trëndafilave

Poezi



SHTËPIA BOTUËSE  
«NAIM FRASHËRI»

## LULET E MITURISË

Këto lule të egra i kam mbledhur

Maleve të jugut, që dikur

Foshnje këmbëzbathur i kam bredhur,

Kur thërrmonin gjylet shkëmb e gur.

Male ka dhe gjetkë e mbase kanë

Madhështi më shumë, apo blerim,

Po për sytë e shpirtin tim nuk janë

Kurre siata të jugut tim!

Nuk e di, po edhe vetë stralli

N'ato vise duket sikur flet!

Për një shkrep të tyre të merr malli,

Për një rrjedhëz zajeve tek shket!

Le pastaj po të kujtosh këmborët,

apo culën, tek me mall kumbon

Majave, kur nis e shkrin dëbora

Dhe në shpate bari mugallon!

N'atë vlug mahnitës gjelbërimi,  
Kaçja e manushaqja çel kudo...  
Këto lule sot, këto kujtime,  
Nisa t'i këpus me mall ndër to,

Edhe duke i mbledhur me ngadalë  
Tufëz te kjo këngë, s'di se si  
Gjendem befas shtegut të një mali,  
Midis shkrepash, zbatbur përsëri...

Ec e ec e dal te një bregore.  
Disku i hënës para më ndriçon,  
Kurse gjyshja pas, me shkop në dorë,  
Herë a herë ndalet e gulçon,  
Duke sharë e nëmur nëpër dhëmbë  
Muhedin Nivicën faqezë.  
Që ka ngritur një tabor më këmbë  
Për një plakë grua e një fëmi.  
Kurse unë qesh me vete e mburrem  
Që më ndiqka, me dyfek në krah,  
Goxha kumandari, deli burrë,  
Me një goxha sorrë në qylah!

Ecim, ecim. Ku mbaron kjo rrugë?  
Gurë, shkrepë. Më së fundi, pyll.  
Lart mbi lisa befas ngrihet muga,  
Synë e shndritshëm hënëzës ia mbyll.  
Unë, aherë, duke vërvshëllyer,  
Nis e shpik avaze një nga një

(Veten, domosdo, për të gjënjer,  
Që jam trim e frika nuk më zë).

Pyll sërish. Pas pak diku pushojmë.  
Bëj të fle, po gjumi nuk më vjen,  
Ndonse plumb qepallat më rëndoijnë,  
Ndonse shtatit prehja m'i pëlqen.  
Edhe gjyshja s'fle e më të rrallë  
Psherëtin e pëshpërin diçka... .

— Nëno, — i them, — tregomë ndonjë prallë,  
Nga ato me trim e me pasha! —  
Ajo ngrihet, doçkëzën e butë  
Embël nëpër flokë ma kalon,  
Pa më merr në prehër e me futën  
Shpatullat e brishta m'i mbulon,  
— Ata trima, — thotë, — kanë qenë!  
Ndonjë syresh mbase fle këtu...  
S'janë pralla, o i vogli i nënës,  
Bëmat e të parëve të tu! —

Një zog nate fluturon papritur  
Sipër nesh e terri e përpin.  
— Ç'qe ky zog? — them unë i çuditur,  
— Ndonjë zemër, — gjyshja mërmërin, —  
Gjithë zogjtë zemra trimash janë,  
Trimash që nuk janë më tanë,  
Se për këtë vend në luftra ranë,  
Kush me kordhë e kush me plumb në gji.

Flij tani! — më thotë...

E qysh aherë

Shpirti im për zogjtë u bë fole.

Ja, përmes ylbereve, pranvera

Vjen plot lule e vallen hedh mbi dhe!

Por kjo festë e madhe e natyrës

S'do të kish, pa zogjtë, asnje kuptim,

Pa harenë e çirlave të tyre

Nëpër kaltërsinë pa mbarim!

Eshtë malli i miturisë vallë,

Që më zgjon për ta kaq dashuri?

Apo rron atje vërtet e gjallë

Zemra e të parëve të mi,

Zemra e tokës sime?

Tokë e ëmbël,  
Tokë e shtrenjtë e mëmëdheut tim!

Ti sikur je veshur me njëëndërr

Edhe syri zor se bën dallim

Ku në ty fillojnë e ku mbarojnë

Caqet e legjendës! Për çudi,

Edhe flladet, lehtas kur kalojnë,

Sikur i magjeps diçka tek ti

E sikur papritur pëshpërisin,

Me të blerta fjale, gjeth më gjeth,

Vargje rapsodish që të mahnişin,

Po kur zgjohem unë e bëj t'i mbledh,  
Ato ikin larg e fluturojnë,  
Larg, ku s'kaben dot. . .

O mëmëdhe!

Mbase veç fëmijtë e ngatërrojnë  
Jetën me legjendën... Po nga ne,  
C'është ai që s'ndihet krejt fëmijë  
Para teje e nuk të pëshpërit  
Çuçurima të ëmbla dashurie,  
Mbase miturake, po me shpirt?

Duket moshat caqe kohe s'kanë,  
Po lulzojnë tok përbrenda nesh,  
Edhe ngaqë janë pranë e pranë,  
Midis tyre ngatërrohen shpesh.  
Unë e shoh këtë pas kaq vjetësh,  
Këngë të qëmoçme kur dëgjoj:  
Foshnje, si dikur, e ndiej veten  
E më duket sikur i shikoj  
Tek nga thellësitë e kohës dalin  
Trimat e lirisë e nëpër shteg  
Marrin udhën shkrepave të malit.  
Unë, këmbëzbathur pas i ndjek.  
— Ku po veni, — u thërras, — or trima?  
— Krushq, — më thonë, — e që ta marrësh  
Atje lart ku ndizen vetëtimat

*Do ta bëjmë dasmën! —*

*Unë qesh:*

*— Qysh u bëka dasma në gremina?*

*Kë do të martokeni atje?*

*— Nënën e Benito Musolinit, —*

*Më përgjigjen, — se e ka të re!*

*— Pse, nuk paski turk-halldupin hasëm?*

*Apo s'jeni bilbilenjtë ju?*

*— Bilbilenjtë; — thonë; — e bëjmë dasëm*

*Mbi këdo që vjen e shkel këtu!*

*— Hej! — vikas. Po ku vikama ime*

*Mes gjëmimit «Para partizan!»*

*— Befas shkrepëtijnë vetëtimat,*

*Ndizet mali, flaka qiellin çan!*

*Unë veten sa nuk hal me dhëmbë,*

*Që s'më marrin dasmash kësisoj!*

*«Veç të rritem, — them, — nja dy pëllëmbë,*

*Pa s'i pyes fare, pas u shkoj!»*

*Po s'arrita dot ta bëja timen:*

*Shtati deshte vite, s'më kish faj,*

*Kurse lufta s'priti e vec kujtimet*

*Më la pjesë nga gostitë e saj.*

*Duket, koha e gjeti një mënyrë*

*Për t'ia shlyer pengun shpirtit tim,*

*Duke i lënë, si shpërblim, detyrën*

*Këngë për ta kthyer çdo kujtim.*

*Moshë e trëndafiltë e miturisë,*

*Shumëkush kthen kryet pas nga ti,*

*Kur kërkon të shmanget prej hullisë,*

Që çan plugu i kohës, se nuk di,  
Pa e mbajtur kush gjithnjë për dore,  
As ta hedhi hapin...  
Po për ne  
Ti një gurre je me ujë bore,  
Që na zbret nga majat gjer në re,  
Mendje e zemër për të na flladitur,  
Lodhjen të na heqësh në çdo çast,  
E të na kujtosh se jemi rritur  
Jo për t'iu zvarritur kohës pas,  
Por t'i prijmë asaj drejt idealit  
Që na kanë lënë amanet  
T'afërmit e shtrenjtë, që nga mali  
S'erdhën më, po zemra na i thërrret!  
Se ndokujt s'i thamë as «lamtumirë»,  
Një të puthur nuk i falëm dot!  
Thimjo, o vëllathi im i mirë,  
Ku s'të kam kërkuar deri sot!  
Kthjellësi e qiellit ndaj agimi,  
Bukuri e tij, seç ka dicka  
Që më zgjon gjithnjë në zemrën time  
Mall për sytë e tu, o im vëlla!  
Dhe se si më shkasin krejt papritur  
Lotët nëpër faqe, s'e kuptoj,  
Ndonse jam mësuar qysh i mitur,  
Buzën kur ndiej dhembje, të kafshoj,  
Se furi e viteve aherë  
Burreri kërkonte dhe nga ne;  
Deri lodrat tonë binin erë

*Tym baruti... Kohë e ashpër qe!*

*Mituri e brezit tim! Ty radha  
S'të erdhi për dyfek e për gjerdan,  
Por, duke lulzuar aq e bardhë,  
Si shpërthim pranvere në tufan,  
Ti u the fashistëve se s'vritet  
Kurrëjeta te ky shkëmb mbi det,  
Por edhe mes flakësh përtëritet  
E përpin në to armiqtë e vet!*

*O kujtime! O lilje porsi bora,  
Rritur ku në rrah e ku në strall!  
Bëj t'ju mbledh e prap' më dridhet dora,  
Se më zgjoni gjithsecila mall!*

*Dhëmbjet patët vlagë, apo gëzimet,  
Ju për mua jeni krjet njëloj.  
Cilën të këpus për këngën time?  
Kë prej jush nga shoqet të veçoj?*

*Ju nuk jeni lule si të tjerat,  
Që t'ju zgjedh për erë e bukuri,  
Po sëmbime zemre! Ndaj përherë  
Udhën do të marr e do të vi,*

Nëpër tufa këngësh për t'ju mbledhur,  
N'ato shtigje malesh, që dikur  
Foshnje këmbëzbathur i kam bredhur,  
Kur thërrmonin gjylet shkëmb e gur!

\* \* \*

Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
E po njësi është mëvja shqipëri u kthim sëm  
Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
Nëpër tufa këngësh për t'u dethur kisha vate

Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
E po njësi është mëvja shqipëri u kthim sëm  
Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
Nëpër tufa këngësh për t'u dethur kisha vate

Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
E po njësi është mëvja shqipëri u kthim sëm  
Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
Nëpër tufa këngësh për t'u dethur kisha vate

Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
E po njësi është mëvja shqipëri u kthim sëm  
Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
Nëpër tufa këngësh për t'u dethur kisha vate

Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
E po njësi është mëvja shqipëri u kthim sëm  
Më mbyroj, për t'u dethur kisha vate  
Nëpër tufa këngësh për t'u dethur kisha vate

\* \* \*

*Një miku im më pyeti një ditë:  
«Pse, kur në vjersha titulli mungon,  
Shënohen shpesh tre yje? Kjo traditë  
Ka mbetur kot, apo diçka tregon?»*

*«Ka yj të ndezur, ka dhe yj të shuar,  
Që drita, — i thash', — vazhdon u vjen mbi  
dhe,  
Po ka më larg dhe yj të pazbuluar,  
Se rrezja s'u ka mbrritur gjer te ne.*

*Dhe poezia, porsi galaktikat,  
Kështu tre llojesh yjt' e vet i ka;  
Prandaj, kur s'vihen tituj mbi lirika,  
Shënohen shpesh tre yje dhe ndër ta,*

*I pari shpreh të bukurën q'e shohim,  
I dyti, atë që në kujtime rrон,  
Kurse i treti, atë që ne s'e njohim  
Dhe vete frysëzimi e zbulon.»*

\* \* \*

Një mbrëmje, për t'u çlodhur, kisha dalë  
E po shëtisja bregut me ngadalë.

Nga njëri krah sodisja perëndimin,  
Nga tjetri, nëpër rërë, hijen time.

Ajo u zgjat, u zgjat, e më së fundi  
Me muzgun befas njësh u bë dhe humbi.

Nuk di ç'm'u shkrep një çast e ndala hapat  
Të shihja ç'gjurmë kisha lënë prapa.

Po kot i hodha sytë nëpër rërë,  
Në muzgun gri qe kredhur bregu i tërë.

Se si më shkoi një dridhje e thash' me vete:  
Si lum ai, që në mëngjes të jetës,

E sjell ndër mend dhe mbrëmjen herë a herë  
Dhe s'u gëzohet hijeve pa vlerë,

Po rrëh të lërë gjurmë drite prapa,  
Të shohë nëpër ç'rrugë i hodhi hapat.

\* \* \*

\* \* \*

Sy fëmijnorë dhe plot me shkëlqim nga  
T'ëmbël, të thellë e të çiltër, si quell mendimi,  
Gurra, ku nis e në heshtje buron frymëzimi,  
Porta, ku mbyllët pas tyre një kopsht pranveror,  
Sy të çuditshëm! Yje të kaltër, të dlirë!  
Thellë në zemër të shohin me gaz e dëshirë,  
Thellë në zemër të djegin me zjarr dashuror!

## PERRALLA E DIELLIT DHE E VLAGËS SË TOKËS

Një djalosh si drita na takuan  
Duke shkuar rrugës tri syzeza:  
Dhe të tria befas fërgëlluan,  
Fshehtas njëra-tjetrës, flakë u ndezën.

Thotë e para: «Nga vjen, or djalë?»  
«Ç'erë të ka sjellë?» — ia kthen e dyta.  
Më së voglës lëmsh iu mblodhën fjälët,  
Pati turp e nuk i ngriti sytë.

«Unë jam, — tha djali, — vetë dielli.  
Ç'erë më ka sjellë? Dashuria.  
Zbrita fluturim nga kupa e qiellit  
Të marr nuse një nga ju të tria!»

Flet e para: «Po më zgjodhe mua,  
Bëhem hije, të flladis me, erë!»

*Hidhet tjetra: «Unë bëhem krua,  
Të të shuaj zjarrin pérngaherë!»*

*Më e vogla prap' nuk flet, e gjora,  
Flakë s'është e digjet porsi flakë,  
Borë s'është e befas, porsi bora,  
Shkrihet e i bëhet tokës vlagë.*

*Mbetet i habitur djali-diell:  
Qysh u zhduk kjo vajzë kaq papritur?  
E kërkon gjithkund e nëpër qìell  
Më së fundi ngjitet i mërzitur.*

*Thuhet se dhe sot, pas kaqe kohe,  
Sytë i hedh ai nga lartësitë  
Gjithë mall mbi tokë, se mos shohë  
Vashëzën e dashur ndonjë ditë.*

*Papo thuhet edhe se syzeza,  
Shkrirë e bërë vlagë e thellësive,  
Sapo ndien mbi dhe të parat rreze,  
Zjarrin e të gjitha dashurive,*

*Del e bëhet vesë e ndrin, e gjora,  
Mbi kurora lulesh e mbi fletë...  
Vashëza që shkruu porsi bora,  
Vlaga e thellë e tokës, jeta vetë.*

## HARABELAT

S'ka më freski dhe lule mbi lëndinë.  
Nga dielli i gushtit bari u tha, u dogj.  
Veç harabelat zheg e vapë s'dinë, —  
Sa të çuditshëm janë këta zogj!

Të gjithë tok, në tufën e gëzuar,  
Përmbi lëndinë enden papushim,  
Pastaj më vijnë e duke cicëruar  
Më çuçurisin fjalë pa kuptim.

E ç'po më thoni vallë, o çamarrokë,  
Që nuk m'u ndatë gjithë rrugës sot?  
Ju me të gjithë jeni miq e shokë, —  
Ku dini ju se ç'halle ka kjo botë!

Ndërrojnë stinët, shemben kohët, ligjet,  
E ju s'e vrisni mendjen për asgjë;  
Për ju të njëjta mbeten fushat, brigjet,  
Ku të shkujdesur silleni gjithnjë.

*Po ndonse dini vetëm fluturime  
Dhe ngado shkoni, s'thurrni as fole,  
Ju s'vajtët kurrë larg në shtegtime,  
Ju s'e braktisët kurrë këtë dhe,*

*Po thjesht e shkuat jetën, tok me mua,  
Lëndinave dhe brigjeve këtu;  
Dhe unë ndoshta për këtë ju dua,  
Një mall foshnjor më vllazëron me ju!*

\* \* \*

Kur padashur humbas ndërsh kujtime; *ëM*  
Mos më shih me trishtim e mërzi, *ëM*  
Mos m'u ngrys, moj e bukura ime, *E*  
Koha shkon e nuk kthen përsëri. *Po*

Po nga mjegull' e kohës së ikur,  
Ndodh që shpesh ndonjë zë na jehon  
Mallëngjyes, i largët, i mybutur,  
Dhe padashur në shpirt na trishton.

«Mës deapi — m'u jetës — Nuk e shpejtë  
që më dështës»  
«Mës deapi — m'u jetës — i shpejtë si më e  
dështës

«Mës deapi — m'u jetës — i shpejtë si më e  
dështës

\* \* \*

*Më tha një ditë një studente e huaj,  
Një flokëverdhë e imtë dhe nazike:  
«E bukur është poezia juaj,  
Po pak e ashpër, se ka shumë epikë...»*

*Dhe zgjati dorën anash të këpuste  
Një degëz trëndafili në lulishte,  
Por «au!» thirri dhe kafshoi buzën,  
Sepse, për dreq, një gjemb i shpoi gishtin.*

*«Mos qesh! — m'u kthye, — Nuk e sheh  
ç'më gjeti?»  
«E shoh, — i thashë, — por qesh si nuk e  
ditke*

*Që edhe trëndafilat fletë fletë  
E kanë, për bela, njëfarë epike!»*

\* \* \*

Krahët e xhamtë ka shtrirë  
Cikna mbi grykat e pyjet.  
Hëna rri pezull e ngrirë,  
Grimca prej akulli, yjet.

Duket përreth sikurjeta  
Befas ka humbur çdo gjurmë;  
Vecse, nën akuj, rrëketë  
Prap' gurgullojnë me zhurmë.

Dhe nati e bukur u lidh  
Nëntmenin peshq i resh neash;  
Rësh tu si zani, këna e ardh  
E fshat e dha humbë pas resh.

Po nje, ku li t'nehet? Ku humbën  
Aq keq zo maje qithësim do  
A më njeri-tjetrin gjo punëdien  
Ta gjetim që kurat është e sot?

\* \* \*

Në shtegëtim përherë e shkojmë jetën,  
Si ju, si ne, vëllezër gjeologë;  
Ju pas mademesh, kurse ne, poetët,  
Për t'i kërkuar shpirtin kësaj toke.

Në shtigje të mundimshme ne kalojmë  
Endoshta njohim shpesh edhe zhgënjime,  
Po drejt qëllimit përsëri ngulmojmë  
Dhe s'kthehem i nga rruga pa zbulime.

\* \* \*

### Ku jumit e Lëshen Potekozi

Të mitur ne ishim, të mitur,  
Dhe shoqen e lodrave s'di  
Si ndodhi një çast që papritur  
Me zjarr e shtrëngova në gji.

Mbaj mend vetëm fjalët që shkanë  
Aherë nga buzët e saj:  
«I dashur, veç ty të kem pranë,  
Pa jeta rrjedh vetë pastaj...»

Dhe nata, e bukura natë,  
Ushtimën pushoi rreth nesh;  
Kështu si tani, hëna e artë  
U fsheh edhe humbi pas resh.

Po ne, ku u fshehëm? Ku humbëm  
Aq keq sa mos shiheshim dot?  
Sa më njeri-tjetrin s'po mundim  
Ta gjejmë gjékund dhe sot?

## VRESHTI I POEZISË

### Kujtimit të Lasgush Poradecit

— Naimi preu shkurret, shkuli ferrat,  
Pastaj qilizmë truallin punoi;  
Fidanët mbollën me durim të tjerët  
Dhe vreshti i bukur shpatin gjelbëroi.  
Kur vajta unë atje, — më tha Lasgushi,  
Një mbrëmje buzë gjolit tek shëtisnim, —  
Hardhitë kishin lidhur vile rrushi,  
Po «kemi etje!» dukej sikur flisnin.  
Aherë ç'bëra? Nëpër shkëmb të malit,  
Një brazdë hapa deri te burimet  
Dhe më së fundi, ujrat si kristali  
U derdhën nëpër të me mërmërime. —

Si tha këto, mbështeti të dy duart  
Përmbi bastun e shtoi si nëpër lotë;  
— E keni radhën jū për ta punuar  
Këtë të bukur vresht, pa shok në botë.  
Ta rritni të shëndetshëm, ta selitni,  
Ta doni si thesarin më me vlerë;  
Dhe neve, që aty e lamë shpirtin,  
Na sillni nëpër mend ngandonjëherë! . . .

## ATDHEU SOT DO PUNË

Atdheu, mik i dashur, sot do punë  
E jo të rrahësh gjoksin e të thuash:  
«Të shkrep, pa më shihni kush jam unë!»  
Mbase hero ti veten mund ta quash,  
Po cilido që i thotë bukës bukë,  
Ka gjak të kuq shqiptari në damarë  
Dhe s'dihet nesër dorën përmbi pushkë  
Je ti q'e hedh a tjetërkush më parë.  
Prandaj mos kulturis te fjala e fundit!  
Fillo me djersën, ç'vete gjer te gjaku?  
Këtu, or mik, tregohu trim po munde,  
Meqë ta heq dhe trimërinë ojhaku!

\* \* \*

Kujtimit e Langosh Përvetave

Foshnje ishe, foshnje, mike, mbete,  
Ndonse për dikë je grua!  
Ç'dreqin ke, ç't'u shkrep pas kaq vjetësh,  
Që xheloze bëhesh prap' për mua?

Kjo të gjen kur hedh symbyllur hapat,  
Kapur pas fustanit të mamasë;  
Besa e shkelur këngën e ka prapa,  
Këngën, që një jetë mund të zgjasë.

Vetëm për një gjë të jesh e bindur:  
Të të shoh të ngrysur unë s'dua;  
Falja vogëlushit që ke lindur  
Mallin që së thelli ndien për mua!

Po dikur edhe ai në jetë,  
Porsi unë e ti do dashurojë;  
Ti mos bëj si nëna jote, fletët  
Mos ia pre, po le të fluturojë!

## PERRALLA E PLAKUT TË URËS

Qëmoti, thonë, te një urë e gurtë  
Tre vetë deshën t'iknin nga kjo botë.  
Por ua kuptoka mendjen një i urtë:  
«C'e keqe ju ka gjetur?» — vjen u thotë.

Ia kthen m'i riu: «Miken që më deshi,  
Njëtjetri sot ia shpien me dasmorë.,,»  
«Ja ti shpëtove, — foli plaku e qeshi, —  
Po kur të marrë vesh ajo e gjora  
Ç'ia gjeti mikun, pikë mund t'i bjerë.  
Nuk t'ardhka pakëz keq?» Ky mbeti  
shtangur

*Dhe në mendime ra një copëz herë,  
Pastaj u ngrit e shkoi nga kishte ardhur.*

I erdh t  dytit radha: «Mos m  pyet!  
Lirin  humba, kot q  rroj n  bot !» —  
R nkon s  thelli ky, pa ngritur kryet.  
«Po nuk ke humbur jet n!» — plaku i  
thot . —

Dhe kur ke jetën, ke një lumë gjaku,  
Paguaje me çmim të tij lirinë!»

U bind dhe ky nga fjalët që tha plaku,  
La urën pas e humbi në luginë.

I treti fillikat mbi urë mbeti.  
Nga pamja e vrarë, dukej më i mjeri,  
«Po ty, — i flet i urti, — ç'hall të gjeti?»  
Ai mezi përgjigjet: «Humba nderin...»  
Dhe seç kërkon të shtojë nëpër dhëmbë,

Po nuk e lënë dridhmat edhe lotët.  
Aherë plaku merr një gur të rëndë,  
Ia var në qafë e «Mos e zgjat!» — i thotë.  
«Mos është i ftohtë uji. . . » — mërmëriti  
Tek dridhej tjetri, por nga buza shkau!  
Dhe s'tha njeri për të: «I ndrittë shpirti!»  
As lumi që e mori nuk e qau.

## KËGNA E SHEMO KASOS

Maleve përtej në Samarinë,  
Shemo Kasua bashnizamët korr.  
Pik e helm valiu i Janinës  
Vrerin sec e derdhi mbi tabor:

«Ja ma bini lidhur, — tha, — gjaurin,  
Ja me këtë pallë do t'ju grij!»  
Gjarpërin nën gur e vetë gurin  
Ç'i tromaksi ulërim' e tij.

Një motmot firarit pas i ranë,  
S'lanë shkrep pa shkelur e livadh,  
Po shkëlqimn' e kordhës vec i panë,  
Tek i korre e shkiste si sorkadh.

I dërgon që larg e shoqja fjalë:  
«Si do rriten djemtë, a ditëzi?»  
«Me radhiqe e me lëpjetë mali,  
Siç jam rritur vetë!» — i thotë ai.

*Papo na i dërgon pashai fjalë:  
«N'u dorzofsh, të bëra kumandar!»  
«Def, — ia ktheu Shemua, — se s'kam dalë  
Për ofiqe maleve firar!»*

*Dhanë e morën, më në fund e zunë.  
Ç'u habit valiu kur e pa!  
«Bjer, firar, — i tha, — këtu më gjunjë!»  
Po më gjunjë Shemua nuk i ra!*

*Shfryny valiu: «Ja ta ul ty hundën,  
Ja në hell të shkoj këtu tek je!»  
«Shkomë, — i thotë trimi, — dhe po mundë,  
Piqma edhe zemrën për meze!»*

*Sic u tha, u bë. Më pas u ndalën  
Zemrën t'i kërkonin, po më kot;  
Zemra zog qe bërë e nëpër male  
Fluturonte e fluturon dhe sot.*

## KËNGA E FATIMESË<sup>1)</sup>

Lulëzove midis frorit,  
Bora pa u shkrirë endé,  
Njomja e vogël e Bihorit,  
Trimja ti, moj Fatime!

Gjithë hiret t'i kish dhënë,  
Shtatin plep e syrin det,  
Nënëzeza, lokja nënë,  
Që të desh si sytë e vet!

Kur nga malet shkreppte drita,  
Vinin e të zgjonin ty  
Këngë t'ëmbla djemsh petrita,  
Që prej teje s'mbyllnin sy.

1) 16-vjeçarja Fatime Sihariqi u vra gjatë masakrës që bënë çetnikët kundër shqiptarëve të Bihorit, në krahinën e Senicës, më 4 shkurt 1942.

*Po një natë as ti nuk fjete,  
Krisma ndjeve kullës qark!  
Dole shpejt, po shtangur mbete:  
Qielli flakë e toka gjak!*

*«Ah, çetnik, të qastë shkina!  
Qysh le vajzën pa baba?» —  
Thirre ti, apo martina?  
Naçalniku ç'pat që ra?*

*Zjarr i vunë kullës sate,  
Po mbi kullë u ngrite ti  
Fluturim, si zog shtrëngate,  
Te flamuri kuq e zi.*

*Dhëmbshurisht me të mbështolle  
Plagëshumin trupin tënd,  
Vrik pastaj në flakë u hodhe,  
Hasmi vetë u shtang pa mend!*

*Shkrumb u bëre, po mizorit  
Nder e flamur nuk i le,  
Njomja e vogël e Bihorit,  
Trimja ti, moj Fatime!*

## JAHO GJOLIKU

Shkrepri një rrufe, thërrmoi gurin,  
Shkrepri tjetra, lisi u shemb përdhe!  
— Kapedan, xha Jaho, bëhu burrë  
Të përballësh rradhas dy rrufe.

U përpoqën hekuri me strallin,  
Luftë e madhe me gjermanë u ndez.  
Plumbat... njërit bir t'i skuqën ballin,  
Tjetrit, kraharorin mes për mes! —

Mbase u thërrmua guri i shkëmbit,  
Lisi u përbys e u bë prush.  
Burri i Kuçit, mal me dhembje brënda,  
Dy rrufetë i mblodhi fort në grusht.

Thonë s'foli, thonë zbriti shtegut  
Pik' e helm, pastaj u bë veri.  
Mali shfren me gjémën e ortekut,  
Mali shfren me shqotë e me stuhi

Dhe buçasin grykat anembanë,  
Shkrepin çika majat nëpër terr,  
Se bën luftë Jaho kapedani,  
Vetë hakun djemve po ua merr!

## JORDAN MISJA

Kjo dritëz, që vjen prej frëngjisë,  
Më thotë se nata po shket;  
Agimi përjashta qelisë  
Të shkrihem tok më thërret.  
Erdh çasti ngamot lamtumirën  
Dhe zemrën atdheut t'i lë,  
Si peng dashurie prej birit  
Që jetën flijoi për të.  
Kështu e ka lufta! Do bien,  
Për hir të fitores, disa!  
Sa degë prej lisave thyhen,  
Kur derdhen tufanet mbi ta!  
Dhe degë në vlug të blerimit,  
Sic qenë dy shokët e mi:  
Perlati, nga trimat më trimi,  
Dhe Brankoja zemërflori!  
Po prap' vjen pranvera e lisat  
Me bisqe pa numër i vesh;  
Me qindra e mijra filiza  
Do ngrihen në luftë pas nesh!  
Erdh çasti!

Ja, shulin e hekurt

Tek lot prapa derës dëgjoj!  
Por unë endë nuk kam vdekur,  
Endë kam suqi të luftoj!

Po ç'është ajo hije e zezë,  
Që mbiu në prag e s'polot? Ah!  
Ah, qenke ti, pop, për besë  
Të paskan munduar kot,  
Se ne komunistët nuk njohim  
As kryq e as pralla me fe;  
Paraisën ne duam ta shohim  
Jo lart nëpër yj, po mbi dhe!  
Dhe ja... tek e kam vizatuar  
Këtu te ky mur... e shikon?  
Ky gjarpër, pas shkëmbit shtrënguar,  
Stihinë fashiste tregon;  
Po shihe si shkaba nga terri  
Po ngrihet t'i sulet rrufe!  
Kjo shkabë është populli, tmerri  
I çdo tiranie mbi dhe!  
  
Seç deshi njeriu i fesë  
Të fliste, po buza iu ngri,  
Pastaj, porsi hije e zezë,  
Siç erdhi, u zhduk përsëri.  
Por ësht' aq e thellë qetsia,  
Sa hapat ia ndjej tek zvarrit,  
Oh, jo! Po zhurmoka frëngjia:  
Një zogëz kafazin çukit!

Ti qenke, laureshëz gazmore,  
Që sa çel agimi mbi dhe,  
Rreh flatrat mbi fusha, bregore,  
Dhe këngës ia nis me hare?

Kur isha fëmijë, sa herë  
Kam thënë me vete se ti  
S'je shpend si gjith' shpendët e tjerë,  
Po vetëm ndonjë mrekulli!

Se ku aq fuqi ligjërimi  
Një gjoks aq i vogël ta fsheh?  
Tek ti mbase flak' e agimit  
Shndërrohet në këng' e na deh!

Se ja, anembanë qelia  
Me dritë m'u mbush këtë çast  
Që m'erdhe ti lart te frëngja,  
Me të ëmblat çirla plot gaz!

Diku nëpër mjegull papritur  
Më ngjan sikur burgu humbet  
E sikur një diell i ndritur  
Të lodhurit sy po m'i vret...

Pastaj shkrepë malesh vigane  
E pyje plot lis edhe ah...

Në brez kam shtrënguar gjerdanin  
Dhe pushkën kam hedhur në krah... .

Po befas një «çohu!» e çjerrë  
Nga èndërr' e bukur më zgjon!  
Gardiani i vrenjtur në derë,  
Si bisha mbi prenë vështron.  
Pastaj skërmit sytë e ngërdheshet  
E brenda më vjen si kusar.  
«Hë, tundu, — më thotë, — mblidh teshat!  
Siç duket, s'ke zverk për litar:::»

«E pra, — mërmërit kuestori, —  
Vërtet paske lindur me fat  
Ta premë, po dreqi e mori,  
Qefini s'po t'ardhka për shtat... .  
Shiko ç'thotë urdhër' i Romës:  
Akuza për krim terrorist  
T'i hiqet, në rast se personi  
Pranon se nuk qe komunist... .  
Ç't'i bëj këtij zarfi, se besa  
*Mëshire për ju unë s'ndje!*  
Na, merr e firmos këtë shkresë  
Dhe ik, thyej qafën këndeji!  
«E mençur kjo grackë që zgjodhët, —  
I them, — e me sa po shikoj,  
Ky qe zari i fundit që hodhët,

*Po lojën e humbët njësoj!»*

*Dhe shkresën, me stemën e ndyrë,*

*Të ngjyer ndër pellgje me gjak,*

*E marr dhe e gris dhe fytyrës*

*Atij me përbuzje ia flak!*

*E prap' korridori i errët,*

*Ku nuk pipëtin asnje zë.*

*Mbërthyer nga karabinierët*

*Po shkel për së fundi në të.*

*Por sapo hedh hapin e parë*

*N'oborrin, ku bari nuk mbin,*

*Një zë, si prej fundit të varrit,*

*Tek unë i mytur arrin...*

*Pak çaste kalojnë dhe zëra*

*Të tjerë dëgjoj përsëri!*

*C'u ndez shpella e burgut e tëra*

*Nga kënga plot zjarr për liri!*

*«Kurajë, Jordan! Si burrë!» —*

*Një thirrje fuqishëm ushton!*

*Dhe kori i madh, prapa muresh,*

*Një kënge të re ia fillon,*

*Një kënge plot shpirt për Perlatin,*

*Për Brankon, për mua...*

*Oh, ç'zjarr!*

*Kë shtykan me shkelma xhelatët?*

Kë shpien kështu në litar?  
C'pandehin? Mos vallë jam unë?  
Tani s'jam më trup, po jam re,  
Që vij me rrëmbim e furtunë  
Gatitem të shfrej përmbi dhe!  
Përkrat kam Perlat vetëtimën,  
Kam Brankon, të tmerrshmin gjëmim,  
Kam brenda në shpirt besimin  
Te forca e popullit tim! ...

VALA NETËS

Kaq e shtrenjtë kurrë s'më je dukur;

Ti vërtet nuk paske shembëllim!

Ah, moj Neta, sytë e tu të bukur

Cmëndurisht i donte miku im!

Nëse këtë çast i ngrysur mbeta,

Duke të vështruar ty kështu,

Ti mos m'u çudit aspak, moj Neta,

Më kujtuan mikun sytë e tu.

Sa dëshirë do të kisha sonte

T'ju vështroja bashkë që të dy!

Vetëm ta dëgjoje të kendonte

Vargjet, që me zjarr t'i thuri ty!

Ndoshta sot që vite pas lajeta,

Miku prap' në shpirt të mban diku...

Ish e bukur dhembja e tij, moj Neta,

Aq sa ç'janë edhe dy sytë e tu!

\* \* \*

Kur m'erdhi ajo në dhomëzën e thjeshtë,  
Nga brishtesi' e saj  
M'u derdh papritur gjithë freski' e vjeshtës  
Dhe ndjeva të rrëqethura. Pastaj.

Pastaj, përtej dritareve të dhomës,  
Me kryet ulur nga puhiza e lehtë,  
Mes kopështit diku, qershiza e njomë  
Dalëngadalë nisi shkundi fletët.

## VALA E MESDHEUT

Bregdeti im, përjetësi rinie!  
Val' e Mesdheut, që nuk njeh qetsi,  
Përmes Otrantos, muzgu sapo bie,  
E lodhur vjen e prehje gjen tek ti,  
Dhe si kthjellohet n'ujrat e kulluar,  
Që gurgullojnë nga shkëmbinjtë e tu,  
Plot ngazëllim merr udhën më t'aguar,  
Gjersa humbet pas horizontit blu,  
Duke vazhduar, si ndër mijra vjet,  
Shtegtimin e pafund e anekënd  
Duke dërguar viseve nga vete  
Dicka nga dashuri' e shpirtit tënd!  
  
E prap' vjen mbrëmja, e prap', porsi  
gjithmonë,  
Ajo tek ti nga largësirat vjen  
E duke u përkëdhelur deri vonë  
Në gjoksin tënd, fillon e të rrëfen  
Për gjithë ç'ka dëgjuar e ç'ka parë  
Në rendjen mes hapësirash pa kufi,

ARTA E MESDHEGU

Nga Lindja, te ngushtica e Gjiblartarit,  
Nga brigjet e Afrikës, ger tek ti.  
Të flet ajo për varkat peshkatare  
Dhe për anijet, që gjithkund takon,  
Por uturin edhe tërbohet fare,  
Fregata e kryqëzorë kur kujton,  
Që si kuçedra ferri turfullojnë,  
Me gojët shqyer për të vjellë zjarr,  
Të ndezin flakë brigjet nga kalojnë,  
Këtë të bukur pellg ta kthejnëvarr.  
O valë, që në gjë të zien dëshira  
Ta kesh të qetë shtegëtimin tënd!  
Vrapo nëpër të tuat kaltërsira,  
Vrapo e zgjo ndër zemra anekënd  
Gjeniun e guximshëm të lirisë!  
Që deti yt, pa shok mbi dhe ky det,  
Të bëhet sofr' e paqes, miqësisë,  
Për lumturinë e popujve të vet!

## NË TREN

Për këtë vend ti mund të shkruash  
Me qindra e qindra poezi,  
Po je i zoti të na thuash  
Pse bie erë Shqipëri?

Kështu me veten kuvendoja  
Në tren, tek udhëtoja sot  
E nga dritarja po kundroja  
Peizazhet varg me ngjyra plot.

Kur «Pi duhan, or mik?» — më thotë  
Një udhëtar aty karshi.  
Nga sytë e tij të zes, të ngrohtë,  
Buronte vec përzemërsi.

«E pi farmakun. . . » — mërmërita  
Dhe ndezëm tok nga një cigar.  
Më tha se vinte nga Mirdita,  
Se shkonte te një nip ushtar,

Fillova i fola edhe unë,  
Pastaj biseda, ca nga ca,  
Natyryshëm krejt, përfshiu punët,  
Shtëpitë, hallet e gjithçka.

U ndamë si dy miq të vjetër  
Dhe «Ç'gjë e bukur, — thash' me mend, —  
Kjo ngrohtësi për njëri-tjetrin,  
Që kanë njerzit te ky vend!»

A s'është, — thirra i gëzuar, —  
Kjo njerëzore dukuri,  
Diçka vërtet për t'u kënduar,  
Që bie erë Shqipëri?

PAROLE MELICHI

Një mbrëmje si kjo tek shëtisnim,  
N'agim të rinisë të dy,  
Nga turpi i puthjes s'guxonim të flisnim,  
Nuk shiheshim dot në sy.

Po sot, pas kaq viteve ndarë,  
Kur hasemi rrugës të dy,  
A thua nga turpi i puthjes së parë  
S'u shikemi dot në sy?

## BASHKË ME URIMIN

Shtëpi të re ti more, miku im,  
Dhe në gosti nuk le njeri pa ftuar,  
Por unë po ta sjell me një qortim  
Urimin tim: «Të rrini të gëzuar!»  
Se në tryezë sonte të mungon  
Dikush, që hundën ti ia mban përpjetë  
Dhe, pa të drejtë, vajzës ia ndalon  
Ta ketë shok të jetës.

Ai diplomë fakulteti s'ka,  
Siç i do ti dhëndurët e shtëpisë,  
I ati mjeshtër trashëgim i la  
Zanatin e çekiçit dhe mistrisë.  
E ka të ngjarë edhe këtë pallat,  
Ku ti ke ardhur sot, ai e ngriti,  
Me djersën duke derdhur në çdo kat  
Dhe dashurinë e shpirtit.  
Ajo këtu gjithkund sikur këndon,  
Në muret, në tavanet, dyshemetë!

\* \* \* \*

Dëgjoje, mik, se mbase tē kujton  
Që rrënjet te kjo klasë i ke dhe vetë,  
Dhe vajzën tënde s'do ta bësh me faj  
Në diti kujt t'ia falë dashurinë,  
Sepse, me çiltërsi, te miku i saj

Ajo kërkoi njerinë!

Mu bës...  
Kaq e caktuar...  
Mu bë...  
Narë për mesë u dhënë dorës ia, atës u...

Që mësi c'presillant rëq ilot qib iñsi  
Se si a grindem / iñsi iñsi që kësiz iñsi  
Dhe mësazem, pëllumbat mëzi është qendër  
Një qarci shekulli qëndës që mësazët oqës

Duro, duro, e glikretn zemër  
Thash, që du udi njurosoj shpejt  
Po befas ti më thirre n'omër  
Pika brasa i shkurtur kreni,

\* \* \*

*Mban mend? Kësaj rruge dolëm  
Natën e lamtumirës.  
Fjalët, që dot nuk i folëm,  
Shiu ia tha errësirës.*

*S'di sonte këndej si kalova,  
Kohët si lash mënjanë;  
Befas m'u duk se dëgjova  
Dy zëra, si zërat tanë:*

*Njëri diç foli për mallin,  
Tjetri sikur psherëtiu...  
E ëdashur, ne ishim vallë,  
Apo errësira dhe shiu?*

\* \* \*

*Medet se ç'hall i madh më gjeti:*

*Nuk e kuptoj se ç'është kjo,*

*Që s'po arrij ta njoh dot veten,*

*Kur jam në èndërr e kur jo!*

*M'u bë sikur, tan i dhe dridhem,*

*Kaq e çuditshme èndërr qe,*

*M'u bë sikur një short i hidhur*

*Na ra për pjesë e sikur ne,*

*Që mezi ç'presim për t'u parë,*

*Se si u grindëm krejt pa shkak*

*Dhe mbetëm, për habi, të ndarë*

*Një çerek shekulli, jo pak!*

*Duro, duro, e shkreta zemër*

*Thash' se do më ngurosej shpejt,*

*Po befas ti më thirre n'emër*

*Dhe brofa i shastisur krejt,*

\* \* \*

*Sa s'munda ta kuptoja fare  
Dhe s'e kuptoj dot as tani,  
Kush ishte èndërr, ajo ndarje  
Apo ky zgjim plot lumturi?*

*Kur dashurove*

Dhe mikja, që të ndrinte ëndërrimet,  
Të fali e drojtur puthjezën e parë,  
Ty të vërshoi i vrullshëm në damarë,  
Porsi një rrjedhë e ngrohtë, ngazëllimi.

*Kur ndjeve dhembje*

Dhe mëma, si dikur kur ishe i mitur,  
Të mori të shtrëngoi fort në gjë,  
Nga përkëdhelja e shtrenjtë e saj, papritur  
T'u kthye qetësia përsëri.

*Po kur gabove*

Dhe shoku, që pandehje se s'të donte,  
Mbi sup të hodhi dorën buzëgaz,  
A mund të kishte vallë horizonte,  
Që ti mos i pushtoje n'atë çast?

\* \* \*

Gëzimn' e dashurisë syzezës a sykaltrës

Ia falim krejt, për vete asgjë nuk mbajmë;  
Zhgënjimn' e dashurisë me mikun më të afërt

Mundohemi vëllazërisht ta ndajmë,  
Kurse kujtimn' e saj e fshehim diku thellë,

Porsi kopraci i prallave thesarin,  
Dhe kyçim dyert mirë kur vemi e

përkëdhelim,  
Se trembemi mos vijnë e na e marrin.

## VALLJA E OSMAN TAKES

*Eh, mor Osman Taka,  
Bir, Osman, me halle!  
Vetëtin me pallë,  
Shkrepëtin me valle!*

*Ngrihesh si shqiponjë,  
Bie si fajkua,  
Papo shkel mbi truall,  
Si sorkadh mbi thua,*

*Sikur do të thuash:  
Ka barut kjo tokë;  
Rëndë po ta shkelësh,  
Bën shaka me kokë!*

*«Ç'bën ky rrënjëdalë, —  
Turfullon valiu, —  
Ç'e pandeh litarin?  
Lodër cilimi?»*

*Ti përdridhesh rrëptë,  
Porsi shakull ere!  
Ç'i kujton halldupit  
Pritat e limeret,*

*Pritat e asqerët  
Prerë e grirë strallit...  
Hijen e meittit  
Ç'i vërvite ballit!*

*Eh, mor Osman Taka,  
Bir, Osman, me halle,  
Një vali Stambolli  
Vrave me një valle!*

## KËSHTJELLA

«...Metulumi, kryeqendra e fisit ilir të  
japodëve, u pushtua prej romakëve pasi  
u bë shkrumb e hi, e pasi, pë r të mos  
rënë në dorë të armikut, burrat luf-  
tuan deri në çastin e fundit, kurse gra-  
të e fëmijët u dogjën në zjarr.»

Karl Patsh 1)

1:



*Po niste dita e re të zbardhëllonte.  
Përmes shtëllungash resh të trëndafilita  
Po regëtinte ylli i mëngjesit.  
Nj' ushtimë e mbytur ngrihej prej ahishtes  
E humbte nëpër mjegullën e bardhë.*

1) Karl Patsh, «Ilirët», Shtypshkronja «Nikaj»,  
Tiranë, 1929,

I ngrysur Oktaviani, zoti i Romës,  
Shëtiste i vëtmuar rrëth shatores,  
Me kryet plot të turbullta mendime.  
Papritur ndali edhe hodhi sytë  
Nga ledhet e kështjellës, që shtrëngonin,  
Porsi një brez i madh, dy maja mali,  
Sikur të qe rrezik se mos rrëshqisnin,  
Nga njëra anë, te një hon i frikshëm,  
Nga tjetra, te një grykë e thellë lumi.  
Kishte kujtuar se me një goditje  
Do t'i rrafshonte krejt, por as hobetë,  
As gjaku i ushtarëve, as grackat,  
S'po mundnin t'i rënonin,

«Metulum! —

Shpërtheu gjithë mllef e rroku shpatën, —  
Kjo ditë lemerisur do të jetë  
O fundi yt i zi, o vdekja ime!»

Dhe sulmi nisi. Dallgë më mizore.  
S'kish parë gjer aherë Metulumi.  
Dragoj të egër, veshur krejt në hekur,  
Iu turrën me tërbim, po prapë u shtangën  
Nga breshër' i shigjetave të mprehta,  
Secila me një vdekje majë saj.  
Aherë portën prap' kështjella e hapi  
Dhe hodhi befas përmbi ta shqiponjat.  
Filloi një e përbindshme përleshje,  
Që s'mbahej mend prej kohe n'ato vise,  
U ngrit një tym, një pluhur aq i dendur,  
Sa s'mund ta njihte qeni më të zonë,

Dhe tek rropama e rreptë rrihte qielin,  
Mbi dhe filloi të rridhte gurra e gjakut.

U derdh gjithçka mbi ledhet e qytetit,  
Po prapë ai s'po jepej.

«Sillni urat!» —

Dha urdhër Oktaviani.

Menjëherë,  
Térhequr prej hamshorësh të fuqishëm,  
Në shesh të luftës rrapëtinë urat.  
U ngrit e para, u vendos mbi ledhe  
Dhe nisën shpejt të njëtëshin në të  
Me dhjetra legionarë. Por, papritur,  
Një grup ilirësh dolën vrik nga porta,  
E shtynë urën fort dhe ajo ra  
Me gjithë ata që mbante sipër.

«Tjetrën!» —

Buçiti i tèrbuar Oktaviani;  
Porse kur pa si ra plot zhurmë e klithma  
Dhe ura e dytë, tëmthat sa s'i plasën!  
Aherë mori një vendim t'atillë,  
Që rrallë mund ta marrin perandorët:  
Dha urdhër të gatitej ura e tretë,  
Pastaj u hodh mbi të i pari vetë!  
Të gjithë u shtangën!... Shpejt aherë hipën  
Ushtarë e kapedanë prapa tij,  
Po ura u rëndua e befas krisi,  
Pastaj u thye e ç'ishin sipër ranë  
Mbi njëri-tjetrin duke ulëritur.

Kështjella shungulloi nga brohoritë  
Dhe n'atë çast s'kish forcë ta përbante  
Guximin' e luftëtarëve të saj!  
Romakët panë tmerr e zunë t'iknin  
Nga sytë këmbët.

Por, kur pa ushtrinë  
N'atë rrëmujë e shthurrje, Oktaviani,  
Dhëmbështrënguar e fytyrëprishur  
Nga dhembja e krahut që kish thyer, brofi  
Dhe rregullin vendosi përsëri.  
E fill pastaj m'e tmerrshme u ndez lufta,  
E s'mbeti trup romaku e s'mbeti hekur  
Pa u përplasur egërsisht mbi ledhe!  
Dhe kur ra nata, një t'atillë natë  
Të dridhet zemra e s'mundesh ta  
përshkruash,  
Fëmijët, duke qarë e duke brritur,  
Kërkonin prindët nëpër terr, dhe nënët,  
Me leshra të lëshuara vajtonin  
Mbi kryet e të vrarëve.

Të ngrysur,  
Si vetë nata, edhe ata burra  
Që kishin mbetur gjallë, helm pikonin  
Edhe mallkonin veten, pse nuk ranë  
Në log të trimërisë atje me shokët!

Po satin më të zi n'atë mynxyrë  
 E pati vajza e prijësit të fisit.  
 Teuta quhej. Qe në prill të moshës.  
 Por, lidhur me zinxhirë e gjysmë e zhveshur,  
 Rrethuar prej romakësh, që pareshtur  
 E fyenin me fjalët më të ndyra,  
 Ajo s'e deshte veten. Gurra e lotit.  
 I kishte ngrirë e gur qe bërë e tëra.  
 Kur befas erdh dikush e porsi bishë.  
 E shtyu tutje turmën e ushtarëve.  
 Teuta i nguli sytë, por papritur  
 Iu duk se iu këput diçka në gjoks!  
 E njobhu! Ky qe Kaj Maroni i tmerrshëm,  
 Xhelati i vëllezërve të saj!  
 — Qetësahu, vajzë e mirë, — i tha romaku  
 Dhe nisi ta çlironte nga zinxhirët.  
 Ajo u ftoh e tëra! Veç të zezash,  
 C'të priste tjetër nga ky vrasës foshnjash?  
 E shpunë te shatorja e perandorit.  
 «Do kisha dhënë menjëherë urdhër, —  
 I tha me zë të butë Oktaviani, —  
 Të të lironin e qysh son te t'ikje  
 Në mal, tek ati yt. Por është natë  
 E nata ka rreziqe. Nesër herët  
 Do nisesh tok me kapedan Maronin,  
 Që unë e kam ngarkuar me detyrën  
 Të shtrohet këmbëkryq me atin tënd  
 Për të pushuar luftën... Mjaft u vramë!...»

Teuta e dëgjonte dhe çuditej  
Me ç'mend mundohej ky tiran ta thurte  
Pëlhirën e mashtrimit, që në grackë  
Të zinte, përmes saj, edhe të atin.  
Po tek në vesh i vinte pa pushuar  
Vajtimi edhe kuja nga kështjella,  
Që me sa dukej afër e kish fundin,  
Asaj sikur i lehtësohej zemra,  
Kur shihte si pushtuesit mizorë  
Ua ndienin prap' të vetëve fuqinë  
Dhe se nuk ishte lufta e Metulumit  
Qëndresa e tyre e fundit... Dhe papritmas  
Ia mbyti brengën ndjenjë e detyrës.  
Po ç'armë të përdorte? T'ia përplaste  
Urrejtjen në fytyrë? E pastaj?  
Atë s'e trembnin vuajtjet, as vdekja,  
Por një mjerim m'i rëndë: poshtërimi!  
Prandaj, më mirë, armën e armikut:  
Mashtrimit t'i përgjigjej me mashtrim!  
Mjafton të hidhte këmbën tutje kampit,  
Pa maleve të dashur që e rritën,  
Do gjente një greminë ku të hidhej!  
«Kështu pra, vajzë, shko të mbledhësh  
veten!» —

I foli më së fundi Oktaviani  
Edhe dy roja e morën e përcollën  
Te një shatore, ku një vajzë arape  
I hodhi krahun e iu shtir si motër.  
Ende pa zbardhur mirë, ajo dëgjoi;  
Përtej pëlhirës, zërin e Maronit,  
E fill pas zërit, hingëllima kuajsh.

U ngrit ngadalë, e doli zemërvrarë  
Dhe hodhi sytë për të fundit herë  
Nga ledhet e kështjellës, kur papritur  
U ftoh e nuk i mbeti pikë gjaku!  
Drejt kampit, n'atë çast, zvarrisnin hapat  
Një grup me pleq të moçëm metulumas!  
Ky hap i tyre i lodhur fliste vetë:  
Qyteti ra!

Teuta sa s'bërtiti,  
Por e përmblodhi veten, kur dëgjoi,  
Nga honi i zemrës, zërin e detyrës!  
«Tani ju shpie unë, — mërmëriti, —  
Nga rripat, ku s'kalojnë dot as dhité,  
E në ju zëntë dot im at' në kurth,  
Ç'gosti me ju këndeje do bëjnë korbat!»

3.

Po ç'ishin vallë ata pleq të moçëm,  
Që vinin kokëvarur, të brengosur,  
Në kampin e romakëve? A thua  
Vërtet u dha kështjella?

Oktaviani

Ashtu dhe mbase do të kish kujtar,  
Për gjersa, fill pas lidhjes së marrëveshjes,  
E pasi Metulumi hapi portën,  
Kish dhënë preras urdhërin, që armët  
Të mundurit t'ua jepnin fitimtarëve.

*Sa fort i vrah burrat e kështjellës  
Ky poshtërim i madh!*

*Pas këtij turpi,*

*C't'u duhej vallë paqja e mallkuar?*

*Në nder i fyter rëndë, gjithë qyteti,  
Me burra, gra, fëmijë e pleq të krrusur,  
U mblosh te sheshi i madh e u betua  
Të vdiste e mos pranonte poshtërimin.*

*Aherë ata që zotëronin armët  
Në sùlm u nisën me furi drejt portës,  
Kurse të tjerët zunë të ndërtojmë  
Një stivë drush e trarësh midis sheshit,  
T'i vinin zjarrin, e po qe se trimat  
Të gjithë do të vriteshin në luftë,  
Me foshnjat do të hidheshin në flakë!*

4.

*Teuta, tutje kampit larg në male,  
Po udhëtonte afër një gremine  
E po mundohej t'i veçohej shpurës,  
Ta kishte më të lehtë për t'u hedhur.  
Por befas, që nga shkrepat sipër saj,  
U duk se ra mbi rrugën një ortek!  
Nuk ish ortek, po luftëtarë mali,  
Që vetëtimthi çarmatosën shpurën*

Dhe zvarrë e hoqën te një grykë shpellë.  
Orteku i vërtetë ra më pas,  
Kur shkoi andej kolona e ushtrisë,  
Që s'pa se ku e humbi kapedanin.  
Ata që kokën mundën të shpëtonin,  
Të lemerisur morën arratinë  
Dhe ato gryka e dinë sa prej tyre  
Përpinë n'atë ikje plot llahtar!

Në mbrëmje, kur nga shkrepat lart dalloj  
Kështjellen, që papritur mori flakë,  
Me robërit më prijësi s'e zgjati.  
Të parit iu drejtua Kaj Maronit:  
«Për luftrat kohët kanë vënë ligje,  
Po ju i shkelët... Kjo na jep të drejtën  
Të shkelim edhe ne mbi to pér ju...  
E di, o Kaj Maroni, ç'fund të pret?»  
«E di, — ia ktheu qetas robi, — vdekja.»  
«Ka vdekje e vdekje!» — prijësi gjëmoi,  
Dhe ndjeu se po i rrihte brënda gjoksit,  
Në vend të zemrës, një çekan i rendë.  
«Çdo vdekje është e denjë pér ushtarë.»  
Sërisht mi ftohtas foli Kaj Maroni  
Dhe sytë i shkëlqyen, kur së largu  
Pa flakën që po ngrihej nga kështjella.  
«Ushtari nuk vret gra, nuk vret fëmijë!»  
Iu thakerrua prijësi, se befas  
Iu shfaqën para syve djemtë e tij  
E qindra gra e cilimij të fisit,  
Përgjakur barbarisht nga ky mizor!  
Dhe s'e kuptoi as vetë qysh i erdhii

Gjithë ajo forcë e tmerrshme nëpër duar,  
Kur, si ia flaku me tèrbim pancirin,  
I shqeu ijen dhe mëlçinë ia shkuli!  
U mat ta hante, por ndërrroi mendje.  
Romaku tjetër, pranë Kaj Maronit,  
U drodh nga llahtaria, kur dëgjoi  
T'i bubullinin:

«Merr këtë mëlçi

E shko në kamp e çoja Oktavianit  
T'ia hedhë qenit! Dhe dëgjo këtu!  
T'i thuash: në rrafshoi një kështjellë,  
Nuk do t'arrijë kurrë të rrafshojë  
Gjith' këto male! Ç'më shastisesh?!

Mbathja!»

Romaku bëri disa hapa praptas,  
Me sy të çakërritur nga habia,  
Pastaj u kthye dhe ia krisi vrapi.  
Po thuhet se, kur më në fund arriti  
Në kamp e i tregoi Oktavianit  
Ç'i gjeti atë ditë nëpër male,  
Tirani i tërbuar nxori shpatën  
Dhe dysh e ndau.

Pak më pas dhe qeni,  
Mëlçinë e Maronit kur kafshoi,  
Lëshoi një angullimë e vajti e ngordhi  
Te këmbët e të zot, që deri vonë  
Qëndroi i vetmuar mbi një breg,

*Pa mundur të shkëpuste dot vështrimin  
Nga valëvitja e flakës së kështjellës  
E nga shkënditë e saj, që në hapësirë  
Përhapsin e kthehet e në yje...*

*II. SHKËPTIME*

IL SICILIERE

# J.V. Gëte

## TRËNDAFILJA E LËNDINËS

Trëndafilen djali pa,  
Çelur në lëndinë.  
«Ç'lule e bukur qenka!» — tha,  
Era e saj pa mend e la,  
Prush ia bëri gjinë.  
Trëndafilja e kuqe gjak,  
Lulez e lëndinës!

«Do të të këpus tani,  
Lulez e lëndinës!»  
Mos më prek, o trim i ri,  
Še të shpoj e mjerë ti,  
Qaje djalérinë!»  
Trëndafilja e kuqe gjak,  
Lulez e lëndinës!

Djali i gjorë s'e dëgjon  
Lußen e lëndinës:  
E këput, po gjembi e shpon  
E nga dhembjet s'e shpëton

## SHPETITJA E TË PËRQËSHIRËS

*Asnjë psherëtimë!  
Trëndafilja e kuqe gjak,  
Lulez e lëndinës!*

## VJOLLCA

Te një lëndinë me blerim  
Kish çelur plot freski n'agim  
Një vjollcë e urtë, e drojtur;  
Papritur na kalon atje,  
Si flutur, një bareshë e re,  
Gjithë shënd e gaz  
E këngë plot hare.

«Ah, sikur t'isha, — vjollca tha, —  
Mes luleve m'e bukura,  
Një çast, një çast të vetëm,  
Do më këpuste domosdo,  
Në gji do më shtrëngonte ajo,  
Një çast, një çast,  
Të paktën për një çast!»

Po shkon aty baresha e re  
Dhe nëpër bar as e ve re,  
E shkel të shkretën vjollcë.

## A TOLTOV

«S'ka gjë, — tha lulez' e pafaj, —  
Të bukurës mëri s'i mbaj,  
Se në po vdes,  
Po vdes nga këmba e saj!»

Si fiftur, të pafesishë e të  
Gjithë shëndë e duz  
E kështë që jet pafat.

— «A», zicur fizave, — s'kollëza tifja,  
Mës i jepet më pafesishë  
Nës kast, të që qështë të dëritë,  
Do më gjithçka që mosdo,  
Tës është që më sërishtës do jo  
Nës kast, të që qështë,  
Tës që qështë që sës kast!»

Do shqiptar që pafesishë e të  
Dje mëqët pafat që së t'ë  
E shqiptar që s'pafesishë s'kollëza.

# H. Hajne

SA HERË

LORELVI

*Sa herë n'udhën tënde*

*Mëngjeseve ndodh që kaloj,*

*Gëzohem, o zoçkëz e dashur,*

*Kur ty në dritare shikoj.*

*I dhembshur e krejt i pafajshëm,*

*Vështrimi i syve të tu*

*«Ç'je ti, o i huaj, — më pyet, —*

*Dhe pse heq e vuau kështu?»*

*Poet jam, o foshnjëz, i njohur i*

*Në kombin tim gjerman;*

*Kush njeh midis nesh më të mirët,*

*Patjetër prej tyre s'më ndan.*

*Si unë dhe shumë të tjera*

*Atje heqin keq edhe zi;*

*Kush brengën e madhe kani njohur,*

*Patjetër që dhembjen mardi!*

LORELAI

SA LIRE

Nuk di pse jam kaq i hutuar,  
Kaq brengë pse kam në gji;  
Një prallëz e kohës së shkuar  
S'më hiqet nga mendt' kurrsesi.

Fillon errësohen. Rini  
Në heshtje të thellë dremit  
Dhe shkëmbin në det perëndimi  
Me rrezet e fundit shëndrit.

Atje, majë shkëmbit të lartë,  
Këndonëmësht Lorelai;  
Dhe petku i shtatit, i artë,  
Dhe krehri në dorën e saj.

Papo në t'artën gërshtetëz  
Plot hir ajo krehrin kalon.  
Dhe kënga magjike, fshehtas,  
Gjithë vendin përreth e pushton.

*Shastisur prej saj, lundrari  
Çan rrjedhën me vrull, po ç'e do:  
Nuk sheh që shkëmbinj ka përpala,  
Se syt' i mban lart tek ajo!*

*Tani un' e di, lum' i gjerë  
Mbi të rrjedh me shkulm e vaj.  
Dhe gjith' këtë gjëmë e bëri,  
Me këngën e saj Lorelai.*

# Xh. Kits

## LAVDIA

*Lavdia, kur ndokush nga pas e ndjek,  
Merr vrapin, porsi egërsira e pyllit,  
E krejt papritur vjen u del në shteg  
Çapkënëve, që fare s'e përfillin.*

*Dhe ësht' aq kryenece, sa përcmon  
Këdo që rri e pret i përvëluar;  
As emrin t'ia përmendësh nuk duron,  
Se dhe ashtu në nder e ke cënuar.*

*Kurbatkë e shkretëtirës është ajo,  
Që valën blu të Nilit ka pasqyrë.  
Prandaj, poet, pas gjurmësh mos i shko,  
Përplasja mospërfilljen në fytyrë,*

*Se me përcmim atë po ta shpërblesh,  
Si skillaven tënde nesër mund ta kesh.*

LIRIKË

Ti qan e loti vetëtin

Qerpiqëve të tu;

Elmazi i vesës në agim

Prej vjollcës shket ashtu.

Ti buzëqesh, ç'i ëmbël gaz

Shëndrit në sytë e tu;

Safiri zbehet n'atë çast

Nga flaka e tyre blu!

Purpurn' e reve ruan ti,

Kur dielli perëndon

Dhe errësira pa kufi

Nis botën e mbulon.

Kështu edhe vështrimi yt

Djeg retë e shpirtit tim;

Le t'erret! Brenda meje ndrit

I zjarrti perëndim!

## KA TASTROFA E PSARASË

Në Psara, ku sundon qetësia,  
Nëpër shkrumb endet vëtëm Lavdia,  
Me vështrimin mbi trimat e ndritur.  
Përmbi flokët, kurorën e vet  
E ka thurur nga bar' i përzhitur,  
Që ka mbetur në tokën e shkretë.

# A. S. Pushkin

## ANÇARI

*Atje ku vapa djeg si zjarri,  
Në trojet tharë e bërë shkrumb,  
I tmerrshëm vigjelon ançari  
Mbi shkretetirën e pafund.*

*Natyra e stepave pa jetë  
È polli në një ditë inati,  
Me vdekje dhé farmak të shkretë  
Kurorën, rrënjët ia spërkati.*

*Kur dielli djeg përmbytja djerrinë,  
Nga korja rrjedh farmaku i shkrirë,  
Pastaj rrëshira nis e ngrin,  
Kur mbrëmja zbret me ftohtësirë.*

*Atje as zogu s'fluturon,  
As tigri s'shkon; tufani i zi  
Te pema e vdekjes veç gjëmon  
Dhe ikën larg me mort në gji.*

MCMLXV

Kur retë udha ndodh t'i shpjerë  
Përmbi kurorën e dremitur,  
Nga degët helmi nis të bjerë  
Si shi mbi rërën e zhuritur.

Njeriu urdhëroi njerinë  
Të shkonte tek ançari plak;  
Kur rezet e agimit ndrinë,  
Ai u kthye me farmak.

Rrëshirë pru prej koreve  
Edhe një degëz të ronitur,  
Dhe djersa e ftohtë, si rrëke,  
I rridhte ballit të venitur.

I pruri dhe u lig, u shtri,  
Pa hyrë në shatore dot,

JAHME TANZTE FOG

Dhe vdiq i gjori skllav satzi,  
Atje nën këmbët e të zot.

Rrëshirën mori princi e shkoi,  
Me helm e ngjeu çdo shigjetë  
Dhe fqinjve vdekjen u dërgoi,  
Përtej kufireve të vet.

## PIKËZA E SHIUT

Pikëza e shiut ra që lart nga retë  
Mbi një kreshtë dallge mu në mes të detit.

«Si do bëj, e mjera, — zu të psherëtijë, —  
Kjo humnerë e egër do të më përpjë!»

Po molusku vajti me gjak e mbuloi,  
Pikëzës, mes dallgësh, jetën i shpëtoi.

Dhe tani, që deti ujrat ka ndërruar,  
Atë e ka shahu perlën më të çmuar.

JAM NJË HARDHI E EGËR

*Jam një hardhi e egër, të tillë e pata fatin,  
Ti bëmu panjë e bardhë, që të të vij rreh shtatit!*

*Jam dredhëz shermasheku, ti bëmu pishë e bukur,  
Të kem se ku të ngjitem, mos ndehem nëpër pluhur!*

*Jam fluturak i drojtur, ti bëmu e fortë flatër,  
Të kridhem në hapsirat e qiellit tënd të kaltër!*

*Jam një dori i lodhur, ti bëmu shpore e shpomë,  
Tek ti, nga largësirat, revan të vij gjithmonë!*

*Jam një vulla i shkrifët, ti trëndafil harlisu  
Në gjoksin tim, që vlagën të mos ma thithin krisjet!*

## LIEDER DER HAMBURGER FRAUEN

Jam mugétira e p lindjes, ti dil që nga  
humnerat

E mjegullat shperndami, si dielli, pérngahera!

Jam nata e pahënë, oh, vello yjsh pa numér  
Ti bëmu, tē mos trembem e tē marr frymë i  
lumtur!

Et hoxë s'motë s'vëndit s'vëndit s'vëndit  
ët barë tissip s'vëndit s'vëndit s'vëndit

Dhe tanë që do t'koh, t'koh, t'koh,  
ët s'motë s'vëndit s'vëndit s'vëndit

tu është s'motë s'vëndit s'vëndit s'vëndit

urëndës lënbëret ët s'vëndit s'vëndit s'vëndit  
s'vëndit s'vëndit s'vëndit s'vëndit s'vëndit

H. Longfellow

SHIGJETA DHE FJALA

Prej harkut u shkëput shigjeta,  
Po ku arriti nuk e di,  
Se mori aq me vrull përpjetë,  
Sa humbi nëpër kaltërsi.

U nis në botë kënga ime,  
Po ku arriti nuk e di;  
Në male e fusha me blerime  
Nuk mund ta ndiqnin sytë e mi.

Kaluan vite dhe shigjeta  
Në trungun e një lisi u gjend,  
Kurse të shtrenjtën këngë e gjeta  
Te zemra e mique, në çdo vend.

## EXCELSIOR<sup>1)</sup>

Përmes një fshati alpin dikur,  
Dëborën çante nëpër terr  
Një trim i ri, me një flamur  
Që kish simbolin plot mister:  
Excelsior!

Vështrimn' e rreptë dhe krenar,  
Si thikë e kish, që shponte larg.  
Dhe zgjonte thirrja e tiј plot zjarr,  
Si bri argjendi, malet varg:  
Excelsior!

Kallkan e ciknë përkundrejt,  
Shtëpi plot ngrohtësi përbri;  
Porse nga buzët, akull krejt,  
Një klithmë ushtonte me furi:  
Excelsior!

---

1) *Excelsior* (*latinisht*) — Përpara dhe më lart .

I tha një plak: «Qëndro, djalosh,  
Se vjen tufani e mbyll çdo shteg  
Dhe ti nuk di se nga të shkosh!»  
Po prap' gjëmimi si ortek:  
Excelsior!

Iu lut një vashëz: «Eja, o trim,  
Rri çlodhu pak në gjoksin tim!»  
Një pikëz lot në faqe i ra,  
Po zemrën mblođhi shpejt e tha:  
Excelsior!

Ia dha tufani! Gjer përdhe  
Përkuli pishat rrëth e qark!  
Po prap' ushtima e rreptë u ndje,  
Përmes rungajash, diku larg:  
Excelsior!

*Agimi ndezi majat zjarr,  
Kur mbi tē psallmēs mērmērim;  
Nē manastirin San Bernar,  
Buçiti thirrja plot guxim;  
Excelsior!*

*Po ku mbet trimi? Borën shpejt  
Rrēmihu qeni i tij, veç kot;  
Ai kallkan qe kthyer krejt,  
Flamur e trup shtrënguar fort!  
Excelsior!*

*Kështu, gjith' nur edhe nē mort,  
Mbet trimi mbi një shkëmb alpin.  
Por amaneti i tij ngamot  
Si ylli udhërrëfyes ndrin:  
Excelsior!*

## II SHQIPËRIMI

### PËRMBAJTJA

#### I. VJERSHA DHE POEMA

Lulet e miturisë .....	5
«Një miku im më pyeti një ditë» .....	14
«Një mbrëmje, për tu çlodhur, kisha dale» .....	15
«Sy fëmijnorë dhe plot me shkëlqim nga mendimi» .....	16
Përralla e diellit dhe e vlagës së tokës .....	17
Harabelat .....	19
«Kur padashur humbas ndër kuftime» .....	21
«Më tha një ditë një studente e huaj» .....	22
«Krahët e xhamtë ka shtrirë» .....	23
«Në shtegtim përherë e shkojmë jetën» .....	24
«Të mitur ne ishim, të mitur» .....	25
Vreshti i poezisë .....	26
Atdheu sot do punë .....	27
«Foshnje ishe, foshnje, mike, mbete» .....	28
Përralla e plakut të urës .....	29
Kënga e Shemo Kasos .....	31
Kënga e Fatimesë .....	33
Jaho Gjoliku .....	35
Jordan Misja .....	37
Netës .....	43
«Kur m'erdhi ajo në dhomëzën e thjeshtë» .....	44
Vala e Mesdheut .....	45
Në tren .....	47
«Një mbrëmje si kjo tek shëtisnim» .....	49

Bashkë me urimin .....	50
«Mban mend? Kësaj rruge dolëm» .....	52
«Medet se ç'hall i madh më gjeti» .....	53
«Kur dashurove..» .....	55
«Gëzimn' e dashurisë, syzezës a sykaltrës» .....	56
Vallja e Osman Takes .....	57
Kështjella .....	59

## II. SHQIPËRIME

J.V.Gëte: Trëndafilja e lëndinës .....	73
Vjollca .....	75
H. Hajne: Sa herë .....	77
Lorelai .....	78
Xh. Kits: Lavdia .....	80
Xh. Bajron: Lirikë .....	81
Dh. Sollomos: Katastrofa e Psarasë .....	82
A. S. Pushkin: Ançari .....	83
M. Saadi: Pikëza e shiut .....	86
Xh. Rumi: Jam një hardhi e egër .....	87
H. Longfellow: Shigjeta dhe fjala .....	89
Excelsior! .....	90